Kopje fotë

GJYKATA RRETHIT GJYQESOR
DURRES
Nr.3198 Prot. Dt 23/08/2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR
Drejtoria e Auditimit te Brendshëm

Nr. 91/1 prot.

Tiranë, më 28/08/2017

Lënda : Ju paraqesim raportin përfundimtar të Auditimit

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
DURRËS

Znj. QELESHI,

Bashkangjitur kësaj shkrese, po ju përcjellim raportin përfundimtar të mbylljes së auditit për institucionin tuaj, të përgatitur nga Drejtoria e Auditimit te Brendshëm, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

DREJTORI
Luljeta Laze

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR
Drejtoria e Auditimit te Brendshëm

Nr. _____prot. Tiranë, më_____ 2017

Lënda : Ju paraqesim Raportin Perfundimtar te Auditimit

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
DURRËS

Znj. QELESHI,

Drejtoria e Auditimit të Brendëshëm në bazë të programit vjetor të auditit te miratuar në Bordin Drejtues per vitin 2017, realizoi misionin e auditimit me objekt: "Vleresimin e veprimtarise se institucionit tuaj" për periudhën 01.01.2015 deri në 31.12.2016.
Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, neni 18 dhe nenin 11 pika c, në Manualin e Auditimit Publik, u hartua Raporti Perfundimtare i Auditit.
Duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit nga ana Juaj dhe të stafit të institucionit që ju drejtoni në kryerjen e auditimit, DAB-ja arriti në konkluzionin se:

Ne perfundim te rishikimit dhe vleresimit te gjetjeve grupi i auditimit arrin ne opinionin se Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres ka menaxhuar drejt veprimtarine ekonomiko-financiare dhe sherbimet gjyqesore, ka administruar drejt vlerat monetare, burimet njerezore dhe asetet ne dispozicion.

Nga auditimi i ushtruar në institucionin që Ju drejtoni, u konstatuan disa mangësi , të cilat më hollësisht janë trajtuar te gjetjet nga auditimi. Lidhur me to janë lënë rekomandimet për zbatim nga ju në funksion të permiresimit dhe arritjes se standartit të krijuar si dhe rritjes së cilësisë së funksionimit të institucionit.

Nga ana e gjykatës të vlerësohen rekomandimet e lëna dhe te dakortesuara e te shoqeruara me plan veprimin perkates dhe brenda 20 ditëve të përcaktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij dhe të dërgohet pranë DAB-se.

Për zbatimin e plan veprimit duhet të informoni sipas afateve të përcaktuara

Bashkëngjitur keni Raportin Perfundimtar të Auditimit te hartuar per institucionin tuaj, si dhe pergjigjen e Observacionit, derguar me shkresën nr. 2779 prot. date 03.08.2017 "Aneksi shtese", te hartuar per institucionin tuaj.

Duke Ju uruar punë të mbarë, shpresojmë në bashkëpunimin Tuaj.

Me respekt,

Artur MAMADHAJ

Drejtor i Drejtorise se Auditimit te Brendshem

PASQYRA E LENDES

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II. HYRJE

III. METODA E AUDITIMIT

IV. GJETJET NGA AUDITIMI

V. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TE LENA ME PARE

VI. OBSERVACIONE

VII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

I. Përmbledhje ekzekutive

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 6, gërma "c" e tij, në "Manualin e Auditimit te Brendshem", miratuar me urdherin e Ministrit te Financave nr.110, date 25.10.2016 ''Per miratimin e manualit te auditimit te brendshem ne sektorin publik", programit te auditimit te miratuar ne Bord per vitin 2017 dhe programit te angazhim auditimit Nr. 05 Prot. date 19/05/2017 u krye "*Auditim i Kombinuar*" në përputhje me përcaktimin e pikave te ketij programi.
Gjate auditimit gjetjet jane ballafaquar dhe trajtuar me menaxheret perkates te institucionit duke nxjerre edhe konkluzionet perkatese dhe dakortesuar ne lidhje me permiresimet ne vijimesi.
Ne perfundim te rishikimit dhe vleresimit te gjetjeve grupi i auditimit arrin ne opinionin se Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres ka menaxhuar drejt veprimtarine ekonomiko-financiare, ka administruar drejt vlerat monetare, burimet njerezore dhe asetet ne dispozicion.
Raportimet financiare paraqesin ne menyre te drejte te gjitha aspektet materiale te institucionit dhe i kane dhene menaxherit te larte informacionin e duhur per menaxhimin me eficence dhe efektivitet te fondeve te vena ne dispozicion nga buxheti i shtetit si dhe te ardhurat e perfituara nga realizimi i sherbimeve te administrates gjyqesore sipas legjislacionit ne fuqi.
Parregullsite e konstatuara nga grupi i auditimit gjejne pasqyrim dhe jane trajtuar me hollesisht ne raportin perfundimtare, pika IV "Gjetjet nga Auditimi".

II. Hyrje

Misioni auditimit u krye nga grupi i auditimit i përbërë nga z.Agim Koçi inspektor audit pergjegjes grupi, z.Aristotel Telhaj dhe znj. Marjana Sulshabanaj inspektor audit.
Qëllimi i misionit të auditimit është :

1.Vleresimi i veprimtarise meparshme
2. Vleresimi i veprimtarise aktuale
3. Permiresim i veprimtarise se ardheshme

Për fillimin e misionit, nga grupi i auditimit u zhvillua takimi prezantues, me Kryetaren e gjykates, kancelaren dhe kryetaren e deges se buxhetit ne daten 22/05/2017.
Në takim u prezantua qëllimi dhe tematika e auditimit, ku palët ranë dakord për fillimin e misionit të auditimit, sipas programit të auditimit te pranuar dhe axhendes paraprake.
Mbi bazën e sistemeve të audituar janë dhënë rekomandimet në pikën VII te raportit për :

1. *Sistemin organizativ*
2. *Sistemin e hartimit dhe zbatimit buxhetit*
3. *Sistemin e pagave dhe pagesave*
4. *Sistemin e prokurimeve me vlera te larta dhe vlera te vogla dhe zbatim kontratash*
5. *Sistemin e raportimit publik*
6. *Sistemin e IT*

III. Metoda e Auditimit

Në misionin e auditimit është kushtuar rëndësi metodave dhe teknikave të manualit të auditimit. Janë përdorur metodat dhe teknikat e auditimit si: intervista, llogaritjet matematikore, sondazhet, analize dokumentacioni, përzgjedhja, etj.
Grupi auditimit ka respektuar formatet standard te hartuar ne baze manualit te ri te auditimit dhe ligjit te auditimit te brendshem.
Grupi auditimit është njohur me të gjithë dokumentacionin që ka menduar se është i nevojshëm dhe i ka siguruar gjurma e auditimit ne gjykate.
U plotesuan dy pyetesor per vleresimin e rriskut per fushen e llogarise dhe per mjedisin e kontrollit te brendshem.
Auditimi perfshiu periudhen nga 01/01/2015 deri ne 31/12/2016.

IV. Gjetjet nga Auditimi

4.1. Funksionimi organizativ i Gjykates

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres per periudhen e audituar ka funksionuar në bazë të ligjit nr.9877, date 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ligjeve te tjera te administrimit publik, akteve te nxjerra nga Bordi i Zyres te Administrimit Buxhetit Gjyqesor, Ministria e Drejtesise dhe Keshilli i Larte i Drejtesise.
Ne mungese te nje Rregulloreje te Brendshme te unifikuar per te gjitha gjykatat, ne nevoje te gjykates, me urdherin e Kryetarit te gjykates nr.38 Prot. date 08.12.2012 eshte hartuar dhe miratuar rregullorja specifike për strukturën dhe veprimtarinë e saj, ***ndryshuar me*** urdherat nr.07, Prot. date 02.09.2013; nr.08, Prot. date 06.09.2013; nr.09, Prot. date 06.09.2013; nr.14, Prot. date 30.09.2013; nr.06, Prot. date 14.04.2014; nr.28, Prot. date 01.09.2014; nr.177, Prot. date 22.10.2015; nr.181, Prot. date 27.10.2015; nr.56, Prot. date 15.07.2016.
Kjo rregullore eshte hartuar ne zbatim te Ligjit Nr. 9877 datë 18.02.2008, "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republiken e Shqipërise", neni 18/3, pika (g) "Kompetencat e Kryetarit te Gjykates", "*....Kryejne detyra te tjera ne funksjon te drejtimit administrativ te gjykates, te parashikuara ne aktet ligjore ose nenligjore.....*".
Me urdherin Nr.07, Prot. date 14.04.2014 nga Kryetarja e Gjykates eshte miratuar Kodi Etikes per punonjesit e Gjykates, ku jane te percaktuara qarte rregullat e sjelljes, me te cilin jane njohur te gjithe punonjesit e gjykates.
Në mbështetje të legjislacionit përkatës, Gjykata kryen veprimtarine e saj proceduriale dhe administrative, ku përfshihen: Pranimi, mbajtja dhe administrimi i akteve proceduriale, provave materjale dhe shkresore të paraqitura, organizimi i shortit për ndarjen e çështjeve, si dhe shpërndarja e çështjeve për gjykim sipas shortit, njoftimet dhe komunikimet e akteve proceduriale, përgatitja dhe shpallja e listës së gjykimeve, mbajtja e procesverbaleve të seancës gjyqësore, si dhe respektimi i kërkesave të solemnitetit në gjykim, etj.

Struktura Organizative e Gjykates

Struktura organike e Gjykatës për periudhën e audituar është miratuar nga Ministri i Drejtesise, pa marrë mendim si nga Kryetari i Gjykates ashtu dhe nga Bordi Drejtues i Zyres. Per rrjedhoje struktura organizative nuk është qartësisht e përcaktuar dhe e ndarë, për të përballuar volumin e punes, aktivitetet financiare dhe dokumentare.
Për periudhen e audituar është respektuar struktura e miratuar me Urdherat, nr.153 date 04.03.2014 me 47 punonjes, nr.1477 date 24.02.2015, me 49 punonjes dhe nr.1978/2 date 16.03.2016 me 49 punonjes.
Ne zbatim te V.K.M . nr.118, date 17.02.2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin Nr.23, date 20.01.2016, te KM "Per percaktimin e numrit te punonjesve me kontrate te perkoheshme per vitin

2016 ne njesite e qeverisjes qendrore". ZABGJ me shkresen nr.90, prot. date 23.02.2016, ka miratuar **1(nje) nepunes gjyqesor** me kontrate te perkoheshme pune, per periudhen korrik-dhjetor, me kohe ditore, 8 ore/dite.

Ne zbatim te V.K.M . nr.602, date 31.08.2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin Nr.23, date 20.01.2016, te KM "Per percaktimin e numrit te punonjesve me kontrate te perkoheshme per vitin 2016 ne njesite e qeverisjes qendrore". ZABGJ me shkresen nr. 436, prot. date 06.09.2016, ka miratuar **1(nje) sekretare gjyqesore** me kontrate te perkoheshme pune, per 4 muaj, me kohe ditore, 8 ore/dite.

Punonjësit e gjykates, bazuar në strukturën dhe organikën e miratuar nga Ministri i Drejtesise dhe Bordi drejtues i ZABGJ, trajtohen me Kodin e Punes ndersa pagat i marrin sipas Sherbimit Civil dhe Kodit te Punes per punonjesit mbeshtetes.

Nga auditimi konstatohet se struktura organizative e gjykatës gjate periudhes nen auditimi nuk ka ndryshuar me perjashtim te shteses ne organike te 1(nje) sekretare gjyqesor dhe 1(nje) sanitare ne muajin shkurt te vitit 2015.

Sektori i financës përballon një volum të madh pune që fillon me pagesat e punonjësve, pagesat e shërbimeve të gjykatës, procedurat e prokurimit si dhe me te gjitha transaksionet financiare, perfshire ketu marredheniet me Thesarin, Bankat, Furnitoret , Posten, UKT dhe OSHE... etj. Për këto të fundit, nuk ka asnjë pozicion specifik që ka në përgjegjësi(ekonomist/llogaritar, arketar...etj). Detyra e arketarit kryhet nga magazinjerja e cila mban provat materjale dhe kryen edhe disa detyra te tjera brenda gjykates.

Po keshtu ne organiken aktuale eshte miratuar vetem 1(nje) punonjes sigurie, per vete infrastrukturen qe ka gjykata eshte e pa mundur te mbulohet siguria e gjykates nga nje punonjes sigurie, duke pasur parasyshe aktivitetin e gjykates ne te gjitha ditet e javes, puna qe kryhet nga gjykatesit e gatshem gjate diteve te pushimit (festave zyrtare te shtunave dhe te djelave), shoqerimin e paleve ne sallat e gjykimit etj.

***Opinioni i auditit**: Shtimi ne organike te 1(nje) sekretari regjistrues, 1(nje) punonjesi sigurie dhe 1(nje) ekonomist/llogaritar ne degen e buxhetit do te ndikoje ndjeshem ne cilesine e sherbimit ndaj publikut dhe ne perfomancen e gjykates.*

Praktika e menaxhimit të burimeve njerëzore. Zbatimi i akteve ligjore e nënligjore në lidhje me rekrutimet e reja, largimet nga puna, vlerësimet dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Mbi procedurat e rekrutimit.

Per periudhen e auditimit 01.01.2015 deri me 31.12 2016, per shkak te levizjeve/vendeve vakant te krijuara ne gjykate, si rezultat i largimit nga puna me deshire/kerkesen e tyre, daljes ne pension apo largimit nga puna per shkelje te disiplines ne pune jane bere emerime te reja.

Gjate vitit 2015, jane emeruar/rekrutuar 13 punonjes (dy punonjes si rezultat i shteses ne organike te 1(nje) sekretare gjyqesor dhe te 1(nje) sanitare). Si dhe jane larguar nga puna 11 punonjes, nga keta: 4 punonjesve ju ka mbaruar kontrata e punes me punedhenesin, 4 punonjes jane larguar nga puna me deshiren e tyre dhe me 3 punonjes te tjere eshte zgjidhur kontrata e punes **per shkelje te disiplines ne pune ne menyre te perseritur.**

Gjate vitit 2016, jane emeruar/rekrutuar 5 punonjes, dhe larguar nga puna po 5 punonjes, nga keta: 2 punonjesve ju ka mbaruar kontrata e punes me punedhenesin (shofer), 1 punonjes eshte larguar me deshiren e tij(shoferi), 1 punonjes ka dale ne pension(sekretare gjyqesore) dhe me 1 punonjes(sekretare gjyqesore) eshte zgjidhur kontrata e punes per shkelje te disiplines ne pune ne menyre te perseritur.

Në lidhje me procedurat e rekrutimit u verifikuan me te zgjedhur 5(pese) praktika emerimi/rekrutimi ne pune dhe rezultoi se: Për plotësimin e çdo vendi vakant, eshte ngritur *komisioni ad-hoc*, per hartimin e kritereve konkrete te konkurimit, veç atyre të përgjitheshme, per te realizuar publikimin, mbledhjen e dokumentacionit, konkurimin nëpërmjet intervistimit, dokumentimin dhe arkivimin e te

gjithe procedures. Ne praktikat e verifikuara kryetari i gjykatës ka zgjedhur kandidaturen e pare, sipas vleresimit perfundimtar nga komisioni ad-hoc, me mbarimin e kesaj procedure eshte lidhur me punëmarrësin, fillimisht një kontratë me afat në kohë prove deri ne tre muaj.
Në lidhje me zbatimin e procedurave te largimit nga puna, u përzgjodhen për auditim 7 dosje te punonjesve te larguar nga puna, për të evidentuar zbatimin e legjislacionit përkatës. Dosjet e verifikuara ju perkisnin 3 punojesve te larguar nga puna me deshire/kerkesen e tyre(sekretare gjyqesore), 2(dy) punojesve qe ju ka mbaruar kontrata e punes me punemarresin(nepunes gjyqesor dhe sanitare) dhe 2(dy) punonjesve te larguar nga puna per shkak te shkeljeve ne menyre te vazhdueshme te disiplines ne pune(sekretare gjyqesor). Ne te gjitha rastet jane zbatuar aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi, per zgjidhjen e kontrates te punes.

Regjistri Themeltar i punonjesve
Sipas të dhënave qe ju paraqitën grupit të auditimit, rezulton se ekziston/mbahet regjistri themeltar i punonjesve ne perputhje me nenin 96 "Regjistri", te ligjit nr. 7961, date 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.136/2015. Regjistri themeltar i punonjesve, eshte sekretuar dhe vulosur ne te gjitha faqet. Nga auditimi i dosjeve te punonjesve administrativ, nuk u konstatuan raste te mungeses se dokumentave qe duhet te permbaje dosja personele e cdo punonjesi, duke filluar nga fleta e inventarit, kerkesa per punesim, CV, deshmi penaliteti, vertetim mjeksor, dokument idendifikimi, libreze pune, diploma dhe liste notash, vertetim nga Njesia Bashkiake(adresa e banimit), certifikate familjare, diploma, certifikata trajnimesh, foto pasaporte, kontrata e punes me/pa afat si dhe kontrata e punes(marrja ne prove), pershkrimi i vendit te punes, ku percaktohen detyrat specifike, perfomanca periodike(vleresimi i punes) dhe referenca te tjera. Kerkesa keto te parashikuara ne VKM-ne Nr.117 date 05.03.2014 "Per Permbajtjen, Proceduren dhe administrimin e Dosjeve te personelit ...".

Funksionimi i gjykates
Ne katin e pare te godines te gjykates funksionojne 2(dy) sportelet e sherbimit, ku ofrohet çdo lloj informacioni në lidhje me gjykimet, dhënien e kopjeve të vendimeve, depozitimin e kërkesave, kërkesë padive, ankimeve dhe rekurseve, dhënien e vërtetimeve, dhënien e kopjeve të akteve të ndryshme, depozitimin e kërkesave për shtyrje, si dhe çdo dokumentacion tjetër.
Godina e gjykates nuk ofron ambjent te mjaftueshem per arkiven e gjykates (9 ambjentet e perdorura per arkive jane te tejmbushura, perfshire ketu edhe dy garazhdet). Numri i sallave te gjykimit eshte i pamjaftueshem ne raport me numrin e gjyqtareve, si pasojë në raste të veçanta të shqyrtimit të kërkesave me një kërkues gjykimet të zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve.
Palët dhe publiku në lidhje me gjykimet, oraret e gjykimeve, gjyqtarët, objektin e gjykimit, palët ndërgjyqëse, numrin e sallës e shikojne në **monitorin** e vendosur ne sallen e sherbimit. Pervec monitorit eshte vendosur edhe **kendi i afishimeve** i cli perditesohet cdo dite pune. Jane vendosur 2 (dy) **kuti ankesash** me qellim depozitimi i ankesave te qytetareve. Ne godine jane instaluar dhe funksjonojne sensoret **kunder zjarrit** si dhe bombulat fikese te zjarrit. Ne deren hyrese te paleve eshte vendosur dhe funksionon **dedektori metal.** *Ne katin e pare te godines mungon* ***rafti/dollapi*** *per futjen/mbajtjen e armeve, sendeve te forta metalike qe nuk lejohen te merren me vete ne sallen e gjyqit.* Sistemi i **kamerave te sigurise** eshte funksional, DVR dhe monitori i vendosur ne zyren e specialistit te IT, mundeson 23 pamje te ambjenteve kryesore te gjykates. Gjithashtu gjykata disponon **Website** e saj ku merret informacioni perkates nga publiku.
Ne vleresimin e pergjithshem konstatohet se godina e gjykates eshte e papershtateshme per shkak te gjendjes aktuale teknike dhe funksionale.

Godina e gjykates nuk ofron ambiente te mjaftueshme per salla gjyqi ne raport me ngarkesen, per arkiven e gjykates, per te ofruar ambient per pritje dhe studimin e dosjeve nga avokatet dhe palet, dhe zyra per sistemimin e te gjithe nepunesve te administrates gjyqesore.
Opinjoni i auditit: Gjykata ne bashkepunim me organet kompetente te kerkoje per ndertimin e nje godine te re.

Menaxhimi i rriskut, dhe masat për parandalimin e ngjarjeve që rrezikojnë objektivat(me efektivitet, ekonomi dhe efiçencë). Regjistrimi dhe raportimi i masave për parandalimin e parregullsive, abuzimeve dhe mashtrimeve.

Ne mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me ligjin 110/2015 u krye auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ne kuptimin e këtij ligji menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërine menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetit dhe raportimit, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Njësia shpenzuese, në bazë të nenit 19 te ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2015 dhe 2016. Pyetesoret e vetevleresimit per vitin 2015 dhe 2016 jane derguar ne menyre shkresore dhe elektronike ne ZABGJ, perkatesisht me shkresat nr.12, Prot. date 15.01.2016 dhe nr.49, Prot. date 06.02.2017.

Gjykata ne ushtrimin e aktivitetit te saj ka pasur si mision: menaxhimin efektiv, eficent dhe me ekonomi te fondeve buxhetore te akorduara, ne funksion te zhvillimit te proceseve gjyqesore te drejta, te shpejta, transparente, dhenies se drejtesise ne kushte me akses te plote per qytetaret, duke synuar arritjen e standarteve bashkohore europiane ne kryerjen e proceseve gjyqesore.

Referuar misionit te gjykates, grupi auditimit vleresoi komponentet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (që këtej e tutje MFK): mjedisin e kontrollit, menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni e komunikimi dhe monitorimi.

a. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit perfshin të gjithë elementet e tjerë të MFK, pasi vendos strukturat dhe disiplinën.

Ne zbatim te Ligjit Nr.10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", Kreu II-te, neni 8, pika 8(b), i ndryshuar. Me Urdherin nr.11, Prot. date 16.01.2015 dhe nr.215, Prot. date 31.12.2015 eshte ngritur *Grupi i Menaxhimit Strategjik (G.M.S)* i njesise ne perberje te te cilit eshte Kryetari i Gjykates, ne cilesine e Nepunesit Autorizues, Kancelari, ne cilesine e Menaxherit dhe Kryetarit te Deges se Buxhetit ne cilesine e Nepunesit Zbatues. Ceshtjet kryesore dhe problemet qe kane dale brenda njesise jane parashtruar GMS, me qellim diskutimin e metejshem dhe marrjen e masave perkatese, ne perputhje me nenin 27, pika 1 te ligjit per MFK.

b. Menaxhimi i rriskut

Menaxhimi i rriskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshem mbi përmbushjen e objektivave të njësise publike dhe kryhet për të dhëne siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Rrisku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Në mbeshtetje te nenit 10 te ligjit per MFK si koordinator i riskut është Kryetari i Gjykatës. Rrisqet, të cilat identifikohen, merren parasysh në hartimin e objektivave afatmesem, brënda kapaciteteve

dhe mundësive. Identifikimi dhe vleresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me risqet ne arritjen e objektivave, trajtohen në mbledhjet javore të menaxherëve të institucionit, por nuk jane te formalizuara. Rezultatet dhe konkluzionet e mbledhjeve, i komunikohen stafit për të ndërgjegjësuar praninë e rrisqeve.

Në lidhje me menaxhimin e rriskut, per vitin 2015 dhe 2016 eshte hartuar regjistri i rriskut ne perputhje me kerkesat e nenit 11, pika 2 dhe nenit 12, pika 3(d) te ligjit "Per menaxhimin financiare dhe kontrollin" i ndryshuar, i cili eshte derguar brenda afateve ligjore në ZABGJ bashke me pyetesorin e vetevleresimit, në mënyre elektronike dhe shkresore.

c. Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet, që synojnë reduktimin e rrisqeve me synim përmbushjen e objektivave të njësisë si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të menaxherit.

Një kontroll i rëndësishëm mbi aktivitetin e gjykatës, është ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësive të personelit. Ne Rregulloren e Brendëshme te Gjykates, jane te perfshira pershkrimet e punes per cdo pozicion pune, pergjegjesite dhe detyrat per secilin punonjes.
Ne këtë institucion nje rendesi e vecante i eshte kushtuar garantimit te sigurise, për shkak të funksionit dhe kushteve aktuale. Ambjentet e gjykates jane te papershtateshme dhe te pamjaftueshem, nisur edhe nga disa faktore te cilet nuk favorizojne zhvillimin normal ne aktivitetin e perditshem te gjykates, si:

- Hyrja e gjyqtareve dhe personelit administrativ të gjykatës ne te njejten hyrje.
- Pamjaftueshmeria e ambjenteve per arkivimin e dosjeve gjyqesore.
- Mungesa e ambjenteve te vecanta per studimin e dosjeve gjyqesore nga avokatet kryesisht apo per psikologet.
- Mos pasja e nje teritori te pershtatshem per vendosjen e mjeteve te transportit te gjyqtareve dhe te shoqerimit te te burgosurve.
- Mos pasja e nje vendi te pershtatshem qendrimi dhe pritje per palet ndergjyqese, prokuroret, avokatet, pjesmarresit dhe publikun ne raport me ngarkesen.
- Orari i reduktuar ne sportelet e sherbimit, per shkat te pamjaftueshmerise me stafit.
- Mos sigurimi i aksesit te duhur per personat me aftesi te kufizuar, vecanarisht persa i perket hyrjes per ne sallen e gjyqit.
- Mos pasja mjaftueshem te sallave per gjykim.

d. Informacioni dhe komunikimi

Mekanizmat e kontrollit të pergjithshem zbatohen për të gjitha operacionet dhe kontribojne për zbatimin e duhur të tyre, janë mekanizma të pergjithshem që kontrollojnë funksionimin e teknologjisë së informacionit. Ne këtë institucion këto kontrolle ushtrohen në drejtim të ruajtjes së të dhënave të hyra në servere-t e sistemeve, e konkretisht kryhet back-up i të dhënave të sistemit qëndror të gjykatës, të sistemit (sistemi elektronik i çështjeve gjyqësore), në të cilën regjistrohen të gjitha çështjet gjyqësore dhe ecuria e tyre. Back-up është ditor si lokalisht ashtu edhe nëpërmjet rrjetit të krijuar nga AKSHI dhe Ministria e Drejtësisë. Testimi i këtij procesi është automatik, dhe kryhet nga vetë sistemi duke u mirembajtur nga specialisti i TI-se.
Në këtë institucion, evidentohen përpjekje për të ruajtur sigurinë e të dhënave individuale në çdo kompjuter, por përgjithësisht është lënë në dorë të individeve për të vendosur fjalekalim, si mjet për parandalimin e hyrjeve të paautorizuara. Gjithashtu, nje kontroll i aplikacionit, është edhe mos ndryshimi i informacionit të rregjistruar në sistemin ICMIS mbi të dhënat gjyqësore.

Ne gjykate fuksinon sistemi i menaxhimit te ceshtjeve gjyqesore, i cili gjeneron informacion mbi ceshtjet qe nga moment i regjistrimit deri ne dhenjen e vendimit te gjykimit. Gjithashtu nga projekti "JUST" i USAID eshte realizuar instalimi i sistemit audio ne sallat e gjyqit, i cili realizon regjistrimin audio te te gjithe seances gjyqesore, ne kuader te transparences se procesit. Per sa i perket informacionit financiare, eshte instaluar program "Alpha Web", duke filluar nga viti 2015, aktiviteti financiar dhe buxhetor regjistrohet ne kete program. Kjo ka krijuar mundesine per gjenerimin ne cdo moment te raporteve te ndryshme permbledhese per financen, buxhetin, shpenzimet, personelin etj., duke dhene nje informacion te plote i cili ka krijuar mundesine e gjykimit mbi realizimin apo progresin e objektivave te njesise.

Gjykata disponon website e saj për komunikimin e çështjeve gjyqësore, per publikimin direkt nga sistemi i cështjeve qe regjistrohen. Gje e cila i mundeson publikut, punonjësve dhe gjykatësve te informohen në kohë mbi oraret dhe specifikat e seancave gjyqësore.

e. Monitorimi

Në Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Durres, monitorimi kryhet nepermjet raportimeve periodike te menaxhereve (Kancelari dhe K/D/Buxhetit) tek Kryetarja e Gjykates. Nepermjet raportimeve periodike 3-mujore qe gjykata kryen ne ZABGJ dhe analizave te kryera per fusha te vecanta te veprimtarise se sektoreve te gjykates. Ne perputhje me afatet ligjore dhe nenligjore ne fuqi monitorimi eshte kryer nga DAB-ja e ZABGJ si dhe nga KLSH-ja.

4.2.Hartimi i PBA-s dhe zbatimi i programit të fondeve buxhetore

a. Kriteret e hartimit dhe zbatimit te buxhetit.

Ne zbatim të Ligjit Nr. 9936 dt.26.06.2008 " Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar, udhëzimeve përkatëse te M.F. si dhe vendimeve të Bordit e udhëzimeve të ZABGJ-s, është bëre hartimi, detajimi dhe miratimi i PBA-ve për vitin 2016-2018 dhe 2017-2019. Buxheti është hartuar miratuar dhe dërguar në afat në ZABGJ. Pasqyrat e buxhetit janë plotësuar sipas kerkesave e të shoqëruara me relacionet shpjeguese. Shpjegime të detajuara janë dhene si per investimet ashtu dhe per shpenzimet e funksionimit te parashikuara.

Gjatë auditimit, në drejtim të planifikimit të buxhetit për vitet pasardhëse dhe detajimit të buxhetit të miratuar për vitin ushtrimor, u konstatua se janë përdorur të dhena nga statistikat e viteve të mëparshme, rregullat e thjeshta matematikore, tendencat e çmimeve, rinovimi i teknologjisë, vlerësimi i të dhënave statistikore të viteve të mëparshme, normativave (qoftë edhe orjentuese) të materialeve për konsum, numrin e punonjësve dhe shpenzimet për trajnimin e gjyqtareve por jo te punonjesve te administrates se gjykates. Njekohesisht eshte hartuar parashikimi i te ardhurave dytesore si dhe perdorimi i tyre.

Nga auditimi konstatohet se ne hartimin e PBA-ve nuk ka ''gjurme te auditit'' nga grupi i punes i ngarkuar me hartimin e PBA-se ne perputhje me ligjin 9936 date 26/06/2008 " Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar dhe udhezimin nr 8 date 29/03/2012 ''Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem'' pikat 44-55, ligjin 10296 date 08/07/2010 ''Per MFK'' i ndryshuar neni 4 pika 23/1 dhe neni 9.

b. Zbatimi i Buxhetit

Zbatimi i buxhetit të Gjykatës për periudhen nen auditim është bërë në përputhje me ligjet ''Per zbatimin e buxhetit'' te viteve perkates, udhezimet vjetore perkatese te M.Financave dhe udhëzimin nr 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" dhe sipas programit buxhetor të

miratuar e dërguar nga ZABGJ-ja.Të dhënat e realizimit te zërave kryesorë të buxhetit per periudhen nen auditim paraqiten si më poshte:

Ne 000/lek

Artikulli	Emertimi	Viti 2015			Viti 2016		
		Plan	Fakt	Real.%	Plan	Fakt	Real.%
600	Shp.Paga	49,800	49,726	99.9%	50,300	50,275	100.0%
601	Shp.SSHSH	7,050	7,020	99.6%	7,210	7,148	99.1%
602	Shp.Operative	15,295	15,292	100.0%	19,780	19,780	100.0%
606	Shp.Transferta				67	57	85.0%
231	Shp.Investime	985	977	99.2%	2,280	2,280	100.0%
Shuma:		**73,130**	**73,016**	**99.8%**	**79,636**	**79,540**	**99.9%**
Mbetje:		**114**			**96**		

Konstatohet se gjykata ka menaxhuar dhe realizuar drejt buxhetin e planifikuar. Investimet e realizuara jane fokusuar ne grupin "Mobilje dhe Paisje" kryesisht ne paisje elektronike per shkak te amortizimit te paisjeve te meparshme si dhe paisje te tjera.
Te ardhurat dytesore jane perdorur ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Perdorimi tyre konsiston ne shpenzime operative (art.602) ne masen 80% dhe per investime (art.231) 20%.

c. Auditimi për të ardhurat nga tarifat për shërbime gjyqësore.
Te ardhurat realizohen nga vjelja e tarifes se sherbimeve gjyqesore, fotokopjet e tjera.

ne 000/lek

Arketimet nga Tarifa e Sherbimit Gjyqesor	Viti 2015		Viti 2016	
	Total	10%	Total	10%
Arketim nga taksa e pulles	6,680	668	6480	648
Arketim nga 1% i kerkese padive	8,515	852	10390	1,039
Fotokopje	127	-	207	-
Cdemtime	111	-		-
Shuma:	**15,433**	**1,520**	**16,870**	**1,687**

U audituan 25 % e dosjeve civile te periudhes nen auditim per arketimin e tarifave gjyqesore.
Ne kampionin e perzgjegjur konstatohet se nga ana e gjykates jane aplikuar drejt tarifat gjyqesore bazuar ne Udhezimin e Perbashket te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Drejtesise nr.33 date 29/12/2014 "Per percaktimin e tarifave te sherbimit te administrates gjyqesore e Ministrise se Drejtesise, Prokurorise dhe Noterise" dhe eshte vjele ajo.
Nga dega e buxhetit jane kryer regjistrime kontable analitike te detajuara per te ardhurat e realizuara nga sherbimet gjyqesore dhe nga testimet e kryera rezulton se jane te pasqyruara drejt.

4.3 Zbatimi i procedurave ligjore dhe nen ligjore per pagat, shtesat mbi pagat dhe sherbimet e personelit.

4.3.1 Pagat dhe shtesat mbi page

a.)Respektimi i numrit të punonjësve sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Ministri i Drejtësisë ne urdhërat përkatës.

Sistemi i pagave në Gjykatë, eshte bazuar në Ligjin Nr. 9877 datë 18.02.2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republiken e Shqipërise", VKM nr. 717, date 23.06.2009 "Per pagat e punonjesve mbeshtetes te institucioneve buxhetore dhe te nepunesve te disa institucioneve buxhetore", te ndryshuar me VKM-ne nr.610, date 24.07.2013, VKM-ne nr.589, date 17.07.2013, VKM nr. 690 date 09.10.2012, VKM nr.524, date 16.08.2012. Ligjin nr.7961, date 12.07.1995 "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.

U audituа respektimi i struktures organizative te miratuar per periudhen 01.01.2015 deri me 31.12.2016. Nga auditimi rezultoi se *është respektuar struktura organizative* e miratuar sipas urdherave te Ministrit te Drejtesise nr.153, date 04.03.2014 me 47 punonjes, nr.1477, date 24.02.2015, me 49 punonjes dhe nr.1978/2, date 16.03.2016 me 49 punonjes. Numri organik i punonjesve te miratuar ne strukturen oragnizative te gjykates po thuajse ka qene i pa ndryshuar, me perjashtim te nje ndryshimi ne muajin shkurt te vitit 2015, eshte shtuar 1(nje) sekretare gjyqesor dhe 1(nje) sanitare.

Githashtu ne zbatim te V.K.M . nr.118, date 17.02.2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin Nr.23, date 20.01.2016, te KM "Per percaktimin e numrit te punonjesve me kontrate te perkoheshme per vitin 2016 ne njesite e qeverisjes qendrore". ZABGJ me shkresen nr.90, prot. date 23.02.2016, ka miratuar 1(nje) nepunes gjyqesor me kontrate te perkoheshme pune, per periudhen korrik-dhjetor, me kohe ditore, 8 ore/dite. Po keshtu ne zbatim te V.K.M-se nr.602, date 31.08.2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin Nr.23, date 20.01.2016, te KM "Per percaktimin e numrit te punonjesve me kontrate te perkoheshme per vitin 2016 ne njesite e qeverisjes qendrore". ZABGJ me shkresen nr. 436, prot. date 06.09.2016, ka miratuar 1(nje) sekretare gjyqesore me kontrate te perkoheshme pune, per 4 muaj, me kohe ditore, 8 ore/dite.

Nga krahasimi i numrit te punonjesve te miratuar ne strukturen organizative, me numrin e punonjesve ne fakt, sipas listepagesave nuk rezultuan ndryshime.

b.Përputhja e pagave sipas klasave dhe vëndit të punës, shtesat mbi pagë etj.

Me zgjedhje u audituan listë pagesat per periudhen Prill 2015 - Qershor 2015 dhe Shtator 2016 - Dhjetor 2016.

Nga kryerja e testimeve për saktësinë e llogaritjeve të pages, përputhjes së pages me pozicionin e punes sipas përcaktimeve të bëra në VKM-t përkatëse, shtesave per vjetersi ne sherbim te gjyqtareve, vjetersise ne pune te punonjesve administrativ, per arsimin, per veshtiresi dhe kushtet e punes, përputhjen dhe saktësinë e pagave të paguara ne bankë sipas punonjësve me pagen neto ne listepagesë, rezulton se:

1. Nga testimi i kryer ne lidhje me llogaritjen, ndalesen dhe xhirimin e **Sigurimit suplementar** te detyrueshem per llogari te Deges Tatim Taksave Durres se:

Per periudhen 01 Janar 2015 deri me 30 Prill 2015 per Kryetarin e Gjykates dhe gjyqtaret, Sigurimi Suplementar eshte llogaritur perkatesisht 3% dhe 2 % mbi pagen bruto ne listepagese (me pak), jo ne perputhje me nenin 5 "Masa e kontributeve", pika b dhe c te Ligjit nr. 27/2015 *"Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.8097, date 21.03.1996, "Per pensionet shteterore suplementare te personave qe kryejne fuksione kushtetuese dhe te punonjesve te shtetit", te ndryshuar". Si dhe me Vendimin Nr.77, date 28.01.2015 "Per Kontributet e Detyrueshme dhe Perfitimet nga Sistemi i Sigurimeve Shoqerore dhe Sigurimi i Kujdesit Shendetesor", pika 18 (a)...* citohet se.... *"Për personat me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar dhe personat e tjerë që trajtohen nga skemat e sigurimeve shoqërore suplementare, të cilët derdhin kontribute për pension suplementar, janë:*

a) Punonjësit që kryejnë funksione kushtetuese, punonjësit e lartë të shtetit, sipas funksioneve, në masën 5, ***4 dhe 3 % të pagës bruto.***

Nga perllogaritjet e bera per Sigurimin suplementare te detyrueshem per periudhen 01.01.2015 deri me 30.04.2015, rezulton se; eshte llogaritur, ndaluar e xhiruar per llogari te Deges Tatim Taksave Durres,

me pak shuma ne vleren **103 663 leke,** perkatesisht sipas Tabeles Nr.2 (bashkangjitur raportit perfundimtare te auditimit).

Auditi rekomandon: Te arketohet shuma ne vleren 103 663 leke, perkatesisht sipas evidentimit ne Tabelen Nr.2, te xhirohet per llogari te Deges Tatim Taksave Durres, ne perputhje me Ligjin nr.8097, date 21.03.1996, i ndryshuar si dhe VKM-se Nr.77, date 28.01.2015 "Per Kontributet e Detyrueshme dhe Perfitimet nga Sistemi i Sigurimeve Shoqerore dhe Sigurimi i Kujdesit Shendetesor", i ndryshuar.

2. Nga sondazhet e bera ne lidhje me llogaritjen dhe pagesen e shteses te pages per **vjetersi ne pune** te punonjesve administrativ, rezulton se: Llogaritja dhe pagesa e shteses te pages per vjetersine ne pune eshte bere ne perputhje me piken 6-te te VKM-se Nr.545, date 11.08.2011, i ndryshuar me VKM-ne Nr.589, date 17.07.2013.

3. Nga sondazhet e bera ne lidhje me pagesat e kryera per vleren e pages se grupit per **grupet e diplomave** te arsimit universitare, nuk rezultuan parregullsi, vlera e pages se grupit per grupet e diplomave te arsimit universitare eshte llogaritur dhe paguar ne perputhje me VKM nr.524, date 16.08.2012, lidhja 2, i ndryshuar.

4. Ne perputhje me nenin 22, pika 3(c) te ligjit nr.10296, date 08.07.2000 "Per menaxhimin financiare dhe kontrollin", i ndryshuar, eshte respektuar **sistemi i dy nënshkrimeve,** liste pagesat jane te nenshkruara nga Kryetari i Gjykates/nepunesi autorizues, Kryetarja e Deges te Buxhetit/nepunesi zbatues.

5. Liste prezencat si dokument baze per hartimin e Listepageses jane mbajtur ne perputhje me kerkesat e udhezimit nr.30 date 27/12/2011"Per Menaxhimin e Aktiveve ne NJSP" kreu III paragrafi "Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlere", pika 69 dhe 71. Udhëzimit të Bordit Nr. 3 datë 07/05/2012 " Për Proçedurat e Ruajtjes, Mbrojtjes dhe Kriteret e Kompetencat për Nxjerrjen nga Përdorimi të Aktiveve në Njësitë e Gjyqësorit", kap. V, paragrafi i fundit dhe Udhëzimit Nr. 2.datë 06.02.2012 të Ministrisë Finanacave. Nga testimi qe u krye ne lidhje me perputhjen e diteve te punes te shenuar ne liste pagese me ditet e punes te shenuar ne listeprezence, nuk rezultuan raste mosperputhje.

6. Nga sondazhet e bera ne lidhje me llogaritjen dhe pagesen e **oreve jashtë kohes normale te punes**, në ditë pushimi e festash zyrtare, rezultoi se eshte vepruar ne baze te Udhezimit te Bordit Drejtues te ZABGJ, dale ne vitin 2012 "Mbi unifikimin e praktikave per daljen ne pune dhe pagesat, jashte kohes normale te punes" dhe Udhezimit Nr.1, date 02.11.2015 "Per nje ndryshim ne udhezimin per unifikimin e praktikave per daljen ne pune dhe pagesat, jashte kohes normale te punes" . Te nxjerre ne zbatim te Udhezimit te Ministrise se Financave Nr.16, date 20.07.2011 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.463, date 16.06.2011 te Keshillit te Ministrave".

4.3.2. Shpenzimet e funksionimit dhe shpenzime te tjere

U auditua me zgjedhje dokumentacioni i bankës për periudhën nen auditim*(per vitin 2015, 106 U.Sh nga 416 U.Sh. gjithsej dhe per vitin 2016, 136U.SH. nga 616 U.SH. gjithsej)* ne nje kampion ne masen 25% e transaksioneve.

Në përfundim të auditimit rezulton se dokumentacioni shoqërues i Urdhër Shpenzimeve , si faturat e blerjeve, kontratat, flet hyrjet e magazinës, përmbledhëset e listpagesave dhe listpagesat, etj jane bashkëlidhur dhe vlerat e tyre përputhen me vlerat në urdhër shpenzim(*ne 3 raste te fatura e*

Avokateve te caktuar kryesisht shuma e fatures nuk perputhet me shumen e kontabilizuar pasi nga gjykata jane zbritur nga jashte vlera te cilat nuk jane pranuar, Pagesa nr 29 dt.25/1/2016,Pagesa nr56 dt.09/2/2016,Pagesa nr.180 dt.19/4/2016).

Dokumentacioni shoqërues i cdo transaksioni është i konfirmuar me vulën e thesarit.

Janë kryer rakordimet periodike dhe vjetore me Degën Thesarit, për situacionet e shpenzimeve mujore dhe vjetore të raportuara nga dega e buxhetit dhe janë pjesë shoqëruese e dokumentacionit të bankës.

Nga krahasimi i të dhënave nga konfermat e thesarit me ditarin e bankës konstatohet se të dhënat janë korrekte të sakta dhe të pasqyruara drejt.

Njëkohësisht u bë krahasimi i cmimeve në kontratat e lidhura ,në blerjet me vlera të vogla me faturat e lëshuara nga operatorët ekonomikë si dhe flet hyrjeve të magazinës dhe rezulton se janë të barabarta.

Pagat e punonjësve janë kaluar në llogaritë personale në bankë dhe nga ana e punonjësve nuk ka reklamime.

Nga auditimi u konstatua se pagesa e avokatëve të thirrur kryesisht, është kryer në përputhje me Urdhërin Nr. 1284/3 datë 16.03.2005 të Ministrit Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë "Per miratimin e tarifave te shperblimit te avokateve per dhenien e ndihmes juridike''

Njekohesisht konstatohet se te gjitha faturat e paraqitura nga avokatet jane te nenshkruara si bleres nga ana e Nepunesit Zbatues ne kundershtim me nenin 12 pika 3 a,dhe e.

Për pagesën e perkthyesëve dhe psikologeve është respektuar udhëzimi i K.M nr. 4 datë 12.12.2012" Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor" pika IV por nuk eshte percaktuar koha e perkthimit dhe koha e punes se psikologut dhe dokumentacioni per pagese eshte hartuar nga KDBuxhetit mbi bazen e vendimeve te gjykates.

Nisur nga sa me siper per shpenzimet e kryera per pagesen e avokateve te caktuar kryesisht perkthyeseve, psikologeve konstatohet se nuk ka nje procedure te qarte e cila te respektoje sistemin e nenshkrimit te dyfishtë në përputhje me nenin 22 pika 3b,dhe 3c, te ligjit 10296 date 08/07/2010 "Per MFK"te ndryshuar.

Nga auditimi i shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë, konstatohet se faturimi nga ana e operatorëve të energjisë elektrike dhe ujit kryhet mbi bazën e konsumit të matur nëpërmjet matësave të instaluar dhe kontratave të lidhura .

Për shërbimet postare konstatohet se fatura e operatorit "Posta Shqiptare "shoqërohet me permbledhje te objekteve postare mujore por nuk ka gjurme te rakordimit me regjistrin qe mbam gjykata ne lidhje me kete sherbim.

Auditimi i veprimeve të Arkës dhe i letrave me vlerë

U auditua dokumentacioni i arkës dhe i letrave me vlerë për periudhen nen auditim.

Nga auditimi rezulton se punonjësi i ngarkuar me kryerjen e veprimeve të arkës kryen edhe veprimet e magazines të cilën e ka dhe detyrë parësore referuar edhe strukturës organike të gjykatës. Gjatë gjithë periudhës objekt auditimi është mbajtur manualisht libri i arkës ku pasqyrohen vetëm arkëtimet nga fotokopjet dhe tarifat e njoftimit dhe arkëtimet nga shitja e pullave të taksës .

Per periudhen ne auditim veprimet e arkes dhe te pullave te takses jane kryer ne programin financiar Alpha Web. Vlerat e gjendjeve te arkes dhe pullave te takses te gjeneruara nga programi perputhen me vlerat ne fakt.

Jane kryer rakordimet periodike dhe ne fund te vitit ushtrimor me DRT Durres dhe vlerat gjendje te tyre perputhen .

Grupi i auditimit kreu testimet ne lidhje me arketimet e kryera nga sherbimet e administrates dhe konstatohet se vlerat e arketimeve dhe derdhjeve ne banke perputhen.

Auditimi i veprimeve të magazinës

Nga auditimi rezultoi se, dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të materialeve në magazinë është plotësuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nga dega e buxhetit, regjistrimet e veprimeve të magazinës, në ditar, janë kryer në mënyrë kronologjike .
F.Hyrjet dhe F.Daljet janë prerë mbi bazën e dokumenteve justifikues, fatura blerje me ose pa tvsh për hyrjet e magazinës dhe urdhër dorëzimit ose plan shpërndarjes të autorizuar titullari, për daljet e magazinës një kopje e të cilave sëbashku me dokumentacionin shoqërues është dërguar në degën e buxhetit për kryerjen e veprimeve të mëtejshme. F.Hyrjet dhe F.Daljet janë të firmosura nga magazinjeri dhe financieri.
Si e mete konstatohet se F.Hyrjet dhe F. Daljet priten dy here nje here manualisht dhe nje here ne programin financiar dhe bashkelidhur dokumentacionit jane faturat e prera manualisht. Do te ishte me e sakte qe veprimet te kryhen drejtperdrejt ne program dhe dokumentacioni bashkelidhur te printohej nga programi per te rritur shkallen e sigurise ne kryerjen e rregjisrimeve kontable.
Nga ana e magazinës është mbajtur libri i magazinës në kartela të vecanta ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet dhe gjendjet e artikujve Ndërmjet kartelave të magazinës dhe llogarisë është kryer rakordimi në sasi e në vlerë çdo muaj. Pajisjet dhe materialet e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale të nënëshkruara prej tyre.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres ka në administrim tre autovetura, nga te cilat nje ne gjendje pune dhe dy jo ne gjendje pune.
Njekohesisht konstatohet se gjykata ka ne administrim edhe tre motocikleta te cilat nuk jane ne gjendje pune .
Nga auditimi i ushtruar për shërbimet e mirëmbajtjes së automjeteve rezulton se ato janë kryer me procedure prokurimi "Blerje me vlerë të vogël".
Nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se janë mbajtur fletë e udhëtimet për justifikimin e konsumit të karburantit por kane te regjistruar vetem km.e pershkuara dhe jo sasine e furnizimit me karburant. Fletet e udhetimit jane formal pasi nuk ka autorizim per levizjen e mjetit dhe nuk ka nenshkrim nga nepunesi udhetues.
Njekohesisht konsumi i karburantit për gjeneratorin nuk eshte pasqyruar nepermjet mbajtjes se karteles se konsumit mujor.
Konstatohet se per vitin 2016 e gjithe sasia e karburantit te blere per kete vit (*FB nr. 81 date 23/02/2016 sasia 4767 litra nafte dhe 500 litra benzine*) eshte bere dalje nga magazina me nje F.Dalje (*FD nr. 49 dt.30/06/2016 sasia 4767 litra nafte dhe 500 litra benzine*) dhe jo pjese pjese sipas konsumit mujor te vertetuar me flet udhetimet perkatese.

Auditi rekomandon:

1. Furnizimi i automjeteve me karburant per muajin pasardhes te kryhet pas dorezimit te Flete-Udhetimit te plotesuar sipas standartit nga shoferi ne zyren e buxhetit dhe kontrollit te saj.

Inventarizimi i pasurisë publike

Për të dy vitet është kryer inventari fizik i gjendjes së aktiveve afatshkurtëra dhe Aktiveve afatgjata të trupëzuara, në magazinë dhe në përdorim nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të kryetarit të gjykatës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të inventarizimeve rezulton se është respektuar procedura sipas udhëzimit nr 30 datë datë 27/02/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në NJSP" dhe nuk rezultojnë diferenca. Gjendjet fizike nga kryerja e inventarit perputhen me gjendjet e pasqyruara ne bilancet e viteve ushtrimor perkates.
Per kryerjen e inventareve nga ana e nëpunesit zbatues është hartuar dhe përditësuar regjistri analitik i aktiveve në përputhje me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011"Menaxhimi i Aktiveve në NJSP".

4.4. Sistemi i raportimit publik

4.4.1. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit dhe Pasqyrat Finaciare Vjetore

Per periudhen nen auditim misioni i auditimit u ushtrua edhe në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

Per periudhen nen auditim rregjistrimet kontabile jane kryer ne programin Alpha Web çka ka rritur shkallen sigurise ne lidhje me kronologjine e regjistrimeve dhe saktesine e tyre. .

Nisur nga sa me siper u testuan llogarite e kreditoreve (detyrimeve) sidomos ndaj operatoreve ekonomike per blerje mallra e sherbime, te detyrimeve ndaj DRT Durres per vleren e pullave te takses dhe mjeteve ne ruajtje dhe rezulton se ato perputhen me te dhenat e nxjerra ne bilancin e dorezuar ne degen e thesarit Durres dhe ZABGJ dhe keto te dhena jane te sakta.

U testuan regjistrimet kontable per celjen e fondeve, blerjet, shpenzimet, pagat, regjistrimet e te ardhurave dytesore nga sherbimet e gjykates, veprimet me gjendjen dhe levizjet e aktiveve si dhe pagesat e kryera ndaj operatoreve ekonomike dhe konstatohet se ato jane rregjistruar drejt ne postet dhe llogarite perkatese dhe eshte respektuar kronologjia e ndodhjes se ngjarjes ekonomike.

Konstatohet se gjenerimi i raporteve te programit ne lidhje me burimet njerëzore (*List Pagesat, Kartelat e punonjesve, Nr.punonjesve dhe fondi i pagave, Lista e punonjesve me pagat etj*) si dhe konfigurimet e elementeve te pagave te punonjesve sipas struktures se pagave dhe shtesave e ndalesave te tyre nuk eshte i drejte. Ne lidhje me konfigurimet e punonjesve mungon elementi i pages grupit(*diploma*),veshtiresia eshte e konfigurueshme ne perqindje ndërkohe që duhet në vlerë. Të dy këta elementë të pagës konfigurohen në ambiente të tjera duke ju ndërruar vendet elementëve të pages dhe kjo ben që raportet që kanë lidhje me pagat te jenë jo të sakta .

Gjendjet e llogarive ne celje e vitit ushtrimor 2015(*mbartja fillestare ne program*) perputhen me gjendjen e llogarive ne mbyllje te vitit ushtrimor 2014.

Njekohesisht mbyllja e vitit ushtrimor 2015 eshte realizuar ne program dhe eshte kryer transferimi i gjendjeve te llogarive *(bilancit)* ne vitin e ri ushtrimor. Gjendjet e llogarive te transferuara perputhen me gjendjet e llogarive ne Pasqyrat Financiare te raportuara në të dy vitet ushtrimorë.

Aktivet dhe pasivet jane te pasqyruara drejt ne postet e tyre dhe vlerat e tyre jane te sakta dhe perputhen me inventarizimin e kryer në fund te cdo viti ushtrimor.

Regjistri analitik i aktiveve per periudhen nen auditim mbahet nepermjet programit por disa te dhena si data e blerjes dhe shpenzimet e kryera për mirmbajtjen e tyre nuk gjenerohen nga programi. Në keto kushte do të ishte më e drejtë që ky regjistër të mbahej manualisht në perputhje me udhëzimin nr 30 datë 27/02/2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në NJSP" deri ne realizimin e gjenerimit të plotë nga programi.

Konstaohet se ne veprimet e mbylljes se vitit ushtrimor ka disa mangesi si: llogarite financiare arka, banka jane mbyllur me flete kontabel nderkohe qe duhet te mbyllen ne ambientet e tyre dhe ne raporte paraqesin gjendje jo faktike te tyre. Kjo mangesi vjen si pasoje e mostrajnimit sa duhet te stafit qe punon me programin Alpha Web.

Pasqyrat Financiare *(Bilanci)* eshte hartuar, miratuar dhe dorëzuar brenda afateve ligjore te percaktuara dhe ne hartimin e tyre jane respektuar udhezimet perkatese te nxjerra mga M.Financave.

Amortizimi i aktiveve eshte llogaritur nepermjet programit, jane respektuar normat perkatese te amortizimit dhe jane perfshire te gjitha aktivet afatgjata.

Pasqyrat Financiar pasqyrojne ne menyrë te drejtë gjendjen e aktiveve dhe pasurise se gjykates.

Formatet shoqeruese te Pasqyrave Financiare jane te plotesuara drejt dhe pasqyrojne sakte te ardhurat, shpenzimet, ndryshimet e aktiveve, lëvizjen e Cash-it si dhe burimet njerëzore.

4.5. Sistemi i Prokurimeve me Vlere të Larte dhe Vlere të vogel

Autoriteti Kontraktor, bazuar ne Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM-ne nr.914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu I, neni 4. Si dhe Udhezimin nr.2 date 27.01.2015 "Per hartimin e regjistrit te parashikimit te prokurimit publik dhe regjistrit te realizimit te prokurimit publik". Në mbeshtetje të kërkesave për punë, mallra ose shërbime ka pergatitur dhe dorezuar në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së, ne menyre shkresore dhe elektronike ne organin qendrore ZABGJ, ***Regjistrin e Parashikimit dhe Realizimit te Prokurimit Publik*** per vitin 2015 dhe 2016. Kjo e fundit si organ qendrore, me përgatitjen e regjistrit përmbledhës të parashikimeve të prokurimeve publike dhe publikimin elektronik në faqen e internetit të APP-se, ka derguar Autoritetit Kontraktor per zbatim. Në rastet e ndryshimeve është bëre kërkesa për ndryshimin dhe pas miratimit janë kryer veprimet perkatese.

Nga auditimi mbi prokurimet publike për periudhen nen auditim, rezultoi se:

Auditimi i përputhshmërisë ligjore në lidhje me procedurat e objekteve të prokurimit, u përqendrua kryesisht në segmente të tenderimit dhe kryesisht mbi vlerën e prokurimit të parashikuar duke e krahasuar me vlerën e prokurimit të realizuar; në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratave të publikuara; si edhe në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik fitues, në lidhjen dhe zbatimin e kontratave të ofertuesve fitues. Kështu, duke u nisur nga baza ligjore e mësipërme dhe nga treguesit e audituar, më poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur auditimin mbi procedurat e prokurimeve publike të realizuara nga Gjykata.

- Sipas RPPP, per vitin 2016 jane parashikuar per tu zhvilluar 2(dy) procedura prokurimi me Vlere te Larte nga Autoriteti Kontraktor, me fond limit te pergjithshem 4 050 mije leke me tvsh. Tenderat e parashikuara per tu zhvilluar jane planifikuar te realizohen me proceduren "Kerkese per propozim", 1(nje) me objekt prokurimi "Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes te godines", me fond limit 2 550 mije leke me tvsh, per kontrate sherbimi, planifikuar per tu zhvilluar gjate muajit janar dhe 1(nje) me objekt prokurimi "Paisje elektronike", me fond limit 1 500 mije leke me tvsh, per kontrate blerje malli, planifikuar per tu zhvilluar gjate vitit.

Bazuar ne RRPP rezulton se jane realuzuar ne fakt 2(dy) procedura prokurimi "Kerkese per propozim" me vlere kontrate te lidhur 3 691.58 mije leke me tvsh. Nga auditimi konstatohet se: fondi limit i pergjithshem ne vleren 2 550 mije leke me tvsh i planifikuar per "sherbimin e sigurise dhe ruajtjes te godines", parashikuar per tu realizuar me proceduren e prokurimit "Kerkese per propozim" eshte prokuruar/ndare me 3(tre) procedura prokurimi, konkretisht: per periudhen 01.01.2016 - 23.02.2016, me proceduren "Me negocim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates" (per nevojat e fillim vitit, 20% i shteses te kontrates fillestare). Per periudhen 24.02.2016 - 02.03.2016 me proceduren "Me vlere te vogel" dhe per periudhen 03.03.2016 - 31.12.2016 me proceduren "Kerkese per propozim".

- Gjithashtu bazuar ne RPPP, per vitin 2015 eshte planifikuar per tu zhvilluar 1(nje) procedure prokurimi me Vlere te Larte, "Kerkese per propozim", me fond limit te pergjithshem 2 300 000 leke me tvsh, me objekt prokurimi "Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes te godines" per kontrate sherbimi, planifikuar per tu zhvilluar gjate vitit.

Ne fakt sipas RRPP rezulton se fondi limit i pergjithshem ne vleren 1 917 000 leke pa tvsh dhe 2 300 000 leke me tvsh i parashikuar per tu realizuar me proceduren "Kerkese per propozim" eshte prokuruar/ndare me 3(tre) procedura prokurimi, konkretisht: per periudhen 01.01.2015 - 28.02.2015, me proceduren "Me negocim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates" (per nevojat e fillim vitit, 20% i shteses te kontrates fillestare). Per periudhen 01.03.2015 - 31.03.2015 me proceduren "Blerje me vlere te vogel" dhe per periudhen 01.04.2015 - 31.12.2015 me proceduren "Kerkese per propozim" me vlere kontrate te lidhur 2 304 283 leke me tvsh.

AK per cdo procedure prokurimi te zhvilluar gjate periudhes nen auditim ka ngritur Njesine e prokurimit rast pas rasti.
Autoriteti Kontraktore, bazuar ne piken 1 paragrafi trete te nenit 57 te VKM Nr.914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar. Me Urdherin Nr.20, Prot. date 14.01.2016 ka punësuar me kontratë si ekspert te jashtëm z.Nertil Kanina (Jurist) per procedurat e prokurimit publik (me perjashtim te blerjeve te vogla) qe do te zhvillohen nga Gjykata per vitin 2016. Po ne daten 14.01.2016 eshte lidhur kontrata e sherbimit me z.Nertil Kanina, si ekspert i jashtem, anetar i Njesise se Prokurimit, i cili do te zhvilloje, ndjeke dhe zbatoje procedurat e prokurimit publik qe do te zhvilloje Gjykata gjate vitit 2016, perjashtuar "Blerjet me Vlere te Vogel".
Po keshtu me Urdherin Nr.09, Prot. date 23.01.2015 ka punësuar me kontratë si ekspert i jashtëm z.Nertil Kanina (Jurist) per procedurat e prokurimit publik (me perjashtim te blerjeve te vogla) qe do te zhvillohen nga Gjykata per vitin 2015. Ne daten 26.01.2015 eshte lidhur kontrata e sherbimit me z.Nertil Kanina, si anetar i Njesise se Prokurimit, i cili do te zhvilloje, ndjeke dhe zbatoje procedurat e prokurimit publik qe do te zhvilloje Gjykata gjate vitit 2015, perjashtuar "Blerjet me Vlere te Vogel".
Per tenderat e realizuara gjate vitit 2015 dhe 2016, ne perfundim te auditimit dhe ballafaqimeve gjendja paraqitet si me poshte:

1.Tenderi i zhvilluar ne rruge elektronike me objekt prokurimi "**Ruajtja me roje private te godines se Gjykates Rrethit Gjyqesor Durres, jashte orarit zyrtare te punes si dhe ne ditet e festave zyrtare dhe te pushimit"**, per periudhen 24.02.2016 - 31.12.2016 (10.22 muja), per nje vend roje, me 3.5 roje gjithsej, me pjesmarrje ne konkurim te 11 OE, 4 te kualifikuar dhe 7 te skualifikuar, me 3 ankesa ne AK dhe 1 ne KPP per vleresimin/klasifikimin e kandidateve dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr.23 Prot. Datë 14.01.2016. 2.Fondi limit -pa tvsh 1 823 573.71 leke (10.22 muaj). -me tvsh 2 188 288.45 leke(10.22 muaj). 3.Pr.Prok. "Kerkese per propozim, me EL. 4.Data e zhvillimit te tenderit 04.02.2016, ora 12.00 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi "Trezhnjeva" sh.p.k. 7.Data e lidhjes te kontratës 03.03.2016. 8.Vlera e kontratës - pa tvsh 1 660 362.92 leke. - me tvsh 1 992 435 leke. 9.Difer. mes f. limit e kont. lekë me tvsh. 10.Lik. kont. 1 992 435 leke, ose 100 %.	1.Viola Kondo, Kryetare 2.Juliana Dhima, Anëtare 3.Entila Shkurti, Anëtare	1.Xheni Muka, Kryetare 2.Henri Hatillari, Anëtare 3.Nertil Kanina, Anëtare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përllogaritjen e vlerës së kontratës

Nga Kryetari i AK, ka dalë Urdheri nr.21, prot. date 14.01.2016 per ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperm, komisioni i ngritur per kete qellim ka hartuar specifikimet teknike si dhe ka bere perllogaritjen e vleres te kontrates duke i pasqyruar ne relacionin nr.22, Prot. date 14.01.2016 ne te cilin evidentohet perllogaritja e vleres limit te kontrates dhe specifikimet teknike/termat e references per kete procedure

prokurimi. Fondi limit i llogaritur eshte ne vleren 1 823 573.71 leke leke pa tvsh dhe 2 188 288.45 leke me tvsh, per periudhen 24/02/2016 - 31/12/2016 (10.22 muaj per 3.5 roje, per nje vend roje).

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit

Në Urdhër Prokurim Nr.23, Prot. datë 14/01/2016 është përcaktura që procedura e prokurimit të jetë "Kerkese per propozim". Nga NjP me procesverbalin e dates 14/01/2016 jane hartuar dokumentat e tenderit per kete procedure prokurimi ku pasqyrohet argumentimi i vendosjes te kritereve per kualifikim, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik. Mbas përfundimit të hartimit dhe miratimit të dokumentave te tenderit nga NjP, miratuar nga Kryetarja e AK me nr.25, prot. date 14.01.2016 në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM-se nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, personi i autorizuar eshte futur ne sistemin elektronik, ka hedhur Njoftimin e kontrates dhe dokumentat e tenderit, si dhe ka ftuar 5 OE per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. Njoftimi i Kontrates eshte derguar per tu publikuar ne faqen zyrtare te APP-se me shkresen nr.26, Prot. date 14.01.2016 dhe botuar ne Buletinin e APP-se.
Me nr.76 prot.date 18.01.2016 eshte bere ankese nga shoqeria "Vrana Security Group" shpk prane AK. Ankesa e bere eshte brenda afateve ligjore te ankimimit, Njoftimi i Kontartes dhe dokumentat e tenderit jane publikuar ne faqen elektronike te APP-se ne daten 15.01.2016 (brenda 7 diteve nga publikimi eshte bere ankesa prane AK). OE ankohet se ne kriteret e vecanta te kualifikimit, ne kapacitetin ekonomik dhe financiar eshte kerkuar xhiroja mesatare vjetore per vitin 2015, nderkohe data e zhvillimit te tenderit eshte caktuar ne daten 25.01.2016. Pasqyrat financiare te vitit 2015 kane si afat kohore dorezimi deri ne daten 31.03.2016, me mbylljen e bilancit vjetor. Me shkresen nr.15, prot. date 19.01.2016 eshte pezulluar procedura e prokurimit nga Kryetarja e AK, eshte ngritur komisioni per shqyrtimin e ankeses. Me nr.16, prot, date 20.01.2016 komisioni ka vendosur te mos pranoje ankesen e OE, duke argumentuar se nuk behet fjale per pasqyrat financiare por per xhiron vjetore te vitit 2015 qe eshte e aksesushme ne daten 14.01.2016, afati per deklarimin elektronik dhe i pageses TVSH. Me nr.17, prot. date 20.01.2016 i eshte kthyer pergjigje OE nga AK. Per shkak te pezullimit te procedures te prokurimit afati i zhvillimit te tenderit eshte shtyre ne daten 04.02.2016. OE pas marrjes se pergjigjes nga AK nuk e ka vazhduar ankesen e tij ne KPP.

III.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese

Me Urdherin nr.24, Prot, date 14.01.2016 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ne mbeshtetje te njoftimit te kontrates ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 04/02/2016. Sipas procesverbalit te vleresimit date 05/02/2016 rezulton te kene marre pjese 11 OE. Nga shqyrtimi i dokumentave administrativ, ligjor, ekonomik, teknik te paraqitur nga OE per kriteret e pergjitheshme dhe kerkesave te vecanta per kualifikim, nga KVO-ja jane kualifikuar 4 OE dhe skualifikuar 7 OE te tjere. Ne sistemin elektronik Njoftimi i klasifikimit eshte bere ne daten 05.02.2016.
Me nr.408, prot, date 10.02.2016 eshte bere ankese nga OE "Eurogjici Security" shpk dhe me nr.ska date 12.02.2016 nga OE "Aulona Pol 1" shpk (ankesat e bera prane AK jane brenda afateve ligjore, brenda 7 diteve nga marrja dijeni te OE per klasifikimin). OE ankohen ne lidhje me skualifikimin e tyre per oferte nen kosto ligjore te vleresuara nga KVO-ja, duke pretenduar se llogaritjet e tyre jane bere me dy shifra mbas presjes dhjetore dhe ne perputhje me udhezimin e perbashket APP dhe KPP te nxerre per kete qellim ne daten 01.04.2015. Me Urdherin e K/AK nr.33, prot.date 10.02.2016 dhe nr.37, prot. date 15.02.2016 eshte pezulluar procedura e prokurimit, eshte ngritur komisioni per verifikimin e ankesave dhe kthimin e pergjigjes ankimusve. Me vendimin nr.34, prot.date 10.02.2016

dhe nr.39, prot. date 15.02.2016 eshte vendosur te mos merren parasyshe ankesat e OE. Me shkresen nr.35, prot. date 11.02.2016 dhe nr.40, prot. date 18.02.2016 ju eshte kthyer pergjigja OE ankimues. Nga KVO-ja eshte hartuar Raporti permbledhes me nr. 52, date 01.03.2016, sipas raportit jane kualifikuar 4 OE, fituesi do te vendoset me short.

Me shkresen nr.53, prot. date 01.03.2016 eshte bere njoftimi i OE me vlere oferte te njejte per hedhjen e shortit ne daten 02.03.2016.

Ne procesverbalin nr.55, prot. date 02.03.2016 eshte dokumentuar hedhja e shortit, fitues ka rezultuar OE "Trezhnjeva" shpk me vlere oferte totale 1 702 477.08 leke pa tvsh dhe 2 042 972. 64 me tvsh ose 47 595.11 leke pa tvsh/roje. Njoftimi i fituesit eshte bere me nr.56 prot, date 03.03.2016.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit.

Nga ana e K/AK, është lidhur Kontrata Nr. 57 Prot. datë 03.03.2016 me Shoqerine "Trezhnjeva" shpk, ne vleren 1 660 365.92 leke pa tvsh dhe 1 992 439 leke me tvsh, per periudhen 03/03/2016 - 31/12/2016.

Nga ana e AK nuk eshte nxjerre Urdheri i Brendshem per ngritjen e komisionit te mbikqyrjes se zbatimit te kontrates per **monitorimin e cilesise se realizimit te kontrates**. Kjo jo ne perputhje me nenin 77, pika 3 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"..... *"Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë..... ".*

Dosja e tenderit eshte inventarizuar, por nuk eshte **protokolluar dhe e arkivuar** ..... *"Njësia e Prokurimit në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje duhet të kryejë inventarizimin e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".*

2. Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt prokurimi **"Blerje paisje elektronike"**, realizuar ne vitin 2016, me pjesmarrje ne konkurim te 3 OE, nga te cilet 1(nje) te kualifikuar dhe 2(dy) te skualifikuar, pa asnje ankese dhe me te dhena te tjera si ne tabelen e meposhme:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1. Urdhër Prokurimi Nr.25 date 09.05.2016. 2. Fondi limit - pa tvsh 1 250 000 leke. - me tvsh 1 500 000 leke. 3. Pr.Prok. "Kerkese per Propozim", me EL. 4. Data e zhvillimit te tenderit 20.05.2016. 5. Morën pjesë në tender 3 OE. 6. Fituesi "Shpresa- AL" shpk. 7. Data e lidhjes te kontratës 07.06.2016. 8. Vlera e kontratës 1 490 400 leke me tvsh. 9. Diferenca me fondin limit 9 600 lekë. 10. Lik.kont. 1 490 400 leke ose 100 %.	1.Viola Kondo, Kryetare 2.Juliana Dhima, Anëtare 3.Entila Shkurti, Anëtare	1.Xheni Muka, Kryetare 2.Henri Hatillari, Anëtare 3.Nertil Kanina, Anëtare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përllogaritjen e vlerës të kontratës

Nga Titullari i AK, ka dalë Urdheri nr.98, date 09/05//2016 për ngritjen e komisionit per hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperm, komisioni ka hartuar specifikimet teknike *(sipas standarteve teknike per paisjet elektronike nga AKSHI)*, si dhe ka bere argumentimin e fondit limit, te pasqyruar ne procesverbalin e dates 09/05/2016. Fondi limit eshte llogaritur sipas cmimeve te tregut ne vleren 1 250 000 leke pa tvsh, aq sa eshte fondi limit i pergjithshem i parashikuar ne RPPP ne fillim te vitit 2016 per "Blerje paisje elektronike".

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit

Njesia e Prokurimit e ngritur sipas UP Nr.25 datë 09.05.2016, ka bere argumentimin e vendosjes te cdo kriteri per kualifikim duke i pasqyruar ne Procesverbalin e dates 09/05/2016. Në referim të DST janë vendosur kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kriteret e pergjitheshme, kriteret e vecanta dhe kapaciteti ekonomik dhe financiar) të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik. Me shkresen nr.100, prot. date 09.05.2016 jane miratuar dokumentat e tenderit nga K/AK.
Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM-se nr.914 date 29/12/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", dokumentat e tenderit jane firmosur nga te gjithe anetaret e NjP, se bashku me njoftimin e kontrates te miratuar nga Titullari jane derguar ne forme elektronike per shpallje, ne faqen zyrtare te internetit te APP-se dhe ne Buletinin e APP-se.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese

Me Urdherin nr.99 Prot. date 09/05/2016 eshte ngritur KVO-ja. Sipas Njoftimit te kontrates te publikuar ne faqen e internetit te APP-se dhe shpallur ne Buletinin e kesaj te fundit, tenderi eshte zhvilluar ne daten 20/05/2016.
Anetaret e KVO-se kane hyre ne sistemin elektronik ne daten dhe oren e caktuar sipas njoftimit te publikuar ne faqen e internetit te APP-se. Sipas procesverbalit te vleresimit te dates 26.05.2016 rezultojne te kene marre pjese ne kete procedure prokurimi:

1. "BNT Elektronic's" shpk, me vlere oferte 1 079 400 leke, pa tvsh, skualifikuar.
2. "Shpresa - Al Compjuter" shpk , me vlere oferte 1 242 000 leke pa tvsh, kualifikuar.
3. "Sinteza - CO" shpk, me vlere oferte, 1 079 100 leke pa tvsh, skualifikuar.

Ne procesverbalin e dates 26.05.2016, nga KVO-ja pasqyrohet vleresimi i dokumentave ligjore, administrativ, teknik, te paraqitura nga OE pjesmarres dhe klasifikimi i OE. Nga 3 OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi, 1(nje) OE eshte kualifikuar dhe 2(dy) te tjeret jane skualifikuar per mos plotesimin e kerkesave per kualifikim te vendosura nga AK. Ne përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit ligjor-teknik-administartiv dhe ofertave te paraqitura/dorezuara nga OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi, eshte vleresuar si oferte e sukseshme oferta e paraqitur nga OE "Shpres - AL Compjuter" shpk ne vleren 1 242 000 leke, pa tvsh dhe 1 490 400 leke me tvsh. Nga ana e KVO-se ne daten 03/06/2016 eshte pregaditur raporti permbledhes per Kryetaren e AK per te miratuar proceduren e shqyrtimit,vleresimit dhe krahasimit te ofertave per te bere shpalljen si fitues te shoqerise "Shpresa - AL". Eshte plotesuar dhe derguar Formulari i Njoftimit te Fituesit nr.110, prot date 03.06.2016.

IV. Në lidhje me zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit

Autoriteti Kontraktor, ka lidhur kontraten nr. 111 Prot. date 07/06/2016 me shoqerine "Shpresa - AL", ne vleren 1 242 000 leke pa tvsh dhe 1 490 400 leke me tvsh.

Para lidhjes te Kontrates, nga Operatori Ekonomik fitues eshte dorezuar formulari i sigurimit te kontrates ne daten 06.06.2016 ne vleren 149 040 leke si dhe dokumentacioni perkates.
Dosja e tenderit eshte inventarizuar, por e **pa protokolluar dhe e pa arkivuar.**

Viti 2015

1. Tenderi i zhvilluar ne rruge elektronike me objekt "**Ruajtja me roje private te godines se Gjykates Rrethit Gjyqesor Durres, jashte orarit zyrtare te punes si dhe ne ditet e festave zyrtare dhe te pushimit"**, per periudhen 01.03.2015 - 31.12.2015 (10 muaj), nje vend roje, me 3.5 roje gjithsej, me pjesmarrje ne konkurim te 8 OE, te kualifikuar 4 dhe te skualifikuar 4, me 5 ankesa ne AK dhe 1 ne KPP per vleresimin/klasifikimin e kandidateve dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr.25 Prot. Datë 30.01.2015. 2.Fondi limit -pa tvsh 1 916 666.70 leke (12 muaj). -me tvsh 2 300 000 leke (12 muaj). 3.Pr.Prok. "Kerkese per propozim, me EL. 4.Data e zhvillimit te tenderit 11.02.2015, ora 12.0 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi "Nazeri 2000" sh.p.k. 7.Data e lidhjes te kontratës 31.03.2015. 8.Vlera e kontratës - pa tvsh 1 498. 421.25 leke (9 muaj). - me tvsh 1 798 105.50 leke (9 muaj). 9.Difer. mes f. limit e kont. lekë me tvsh. 10.Lik. kont. 1 798 105.50 leke, ose 100 %.	1.Viola Kondo, Kryetare 2.Juliana Dhima, Anëtare 3.Entila Shkurti, Anëtare	1.Xheni Muka, Kryetare 2.Brunilda Vrapi, Anëtare 3.Nertil Kanina, Anëtare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përllogaritjen e vlerës së kontratës

Nga Kryetari i AK, ka dalë Urdheri nr.24, prot. date 30.01.2015 per ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperm, komisioni i ngritur per kete qellim ka hartuar specifikimet teknike si dhe ka bere perllogaritjen e vleres limit te kontrates duke i pasqyruar ne relacionin nr.24, Prot. date 30.01.2015 ne te cilin evidentohet perllogaritja e vleres limit te kontrates dhe specifikimet teknike/termat e references per kete procedure prokurimi. Fondi limit i llogaritur eshte ne vleren **1 916 666.70 leke pa tvsh** (fondi limit eshte llogaritur **referuar cmimit te tregut**, vjetor per 3.5 roje/1 vend roje). Bazuar ne 3 ofertat e marra ne treg, perkatesisht nga shoqeria "Rogat Security Group" shpk, ne vleren 1 816 654 leke pa tvsh; Shoqeria "Firdeus Group" shpk, ne vleren 2 116 767 leke pa tvsh dhe shoqeria "Firdeus" shpk, ne vleren 1 816 577 leke (1 816 654+2 116 767+1 816 577)/3.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit

Në Urdhër Prokurim Nr.25, Prot. datë 30/01/2015 është përcaktura që procedura e prokurimit të jetë "Kerkese per propozim". Nga NjP me procesverbalin e dates 30/01/2015 jane hartuar dokumentat e tenderit per kete procedure prokurimi ku pasqyrohet argumentimi i vendosjes te kritereve per

kualifikim, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik. Mbas përfundimit të hartimit të dokumentave te tenderit nga NjP, jane miratuar nga Kryetarja e AK me nr.20, prot. date 30.01.2015.
Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenit 39 pika 4 te VKM-ne nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, personi i autorizuar eshte futur ne sistemin elektronik, ka hedhur Njoftimin e kontrates dhe dokumentat e tenderit, si dhe ka ftuar 5 OE per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. Njoftimi i Kontrates eshte derguar per tu publikuar ne faqen zyrtare te APP-se me shkresen nr.19, Prot. date 30.01.2015 dhe eshte botuar ne Buletinin e APP-se.

III.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese

Me Urdherin nr.26, Prot, date 30.01.2015 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ne mbeshtetje te njoftimit te kontrates ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 11/02/2015. Ne mbeshtetje te Procesverbalit te vleresimit te dates 13.02.2015 rezulton te kene marre pjese ne konkurim 8 OE. Nga shqyrtimi i dokumentave administrativ, ligjor, ekonomik, teknik te paraqitur nga OE per kriteret e pergjitheshme dhe kerkesave te vecanta per kualifikim, jane kualifikuar 4 OE dhe skualifikuar 4 te tjere.
Brenda afateve ligjore prane AK jane depozituar 4 ankesa nga OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi ne lidhje me vleresimin e kandidateve, per rrjedhoje procedura e prokurimit eshte pezulluar, jane shqyrtuar ankesat dhe eshte kthyer pergjigje brenda afateve ligjore. OE "Eurogjici" shpk e ka vijuar ankesen ne KPP, ku nga ky i fundit nuk eshte pranuar ankesa dhe eshte lejuar AK te vazhdoje proceduren e prokurimit.
Nga ana e KVO-se me nr.42, Prot. date 16.03.2015 eshte pregaditur raporti permbledhes per Kryetarin e AK per te miratuar proceduren e shqyrtimit,vleresimit dhe krahasimit te ofertave per te bere shpalljen e fituesit me short, pasi OE "Firdeus" shpk dhe "Nazeri 2000" shpk kane paraqitur ofertat e tyre me vlera te barabarta 1 664 912.50 leke pa tvsh. Me shkresen nr.41. Prot. Date 16.03.2015 eshte bere njoftimi i OE per hedhjen e shortit ne daten 17.03.2015 ora 13.00. Ne mbeshtetje te procesverbalit nr.48 Prot. Date 17.03.2015, fitues eshte shpallur shoqeria "Nazeri 2000" shpk me vlere oferte 1 664 912.50 leke pa tvsh. Eshte plotesuar dhe derguar Formulari i Njoftimit te Fituesit me nr.48/1, Prot date 17.03.2015.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit

Nga ana e K/AK është lidhur Kontrata Nr. 59 Prot. datë 31.03.2015 me Shoqerine "Nazeri 2000" shpk, ne vleren 1 498 421.25 leke pa tvsh dhe 1 798 105.50 leke me tvsh, per periudhen 01.04.2015 - 31.12.2015 (9 muaj, **199 789.50 leke/muaj me tvsh**).
Nga ana e AK eshte bere Njoftimi i Kontrates te nenshkruar me shkresen nr.60 Prot, date 02.04.2015, botuar ne Buletinin e APP-se.
Nga ana e AK nuk eshte nxjerre Urdheri i Brendshem per ngritjen e komisionit te mbikqyrjes se zbatimit te kontrates per monitorimin e cilesise se realizimit te kontrates. Kjo jo ne perputhje me nenin 77, pika 3 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku citohet..... *"Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë……."*.
Dosja e tenderit eshte inventarizuar, por **e pa protokolluar dhe e pa arkivuar** ..... *"Njësia e Prokurimit në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje duhet të kryejë inventarizimin*

e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

Auditimi për procedurat e prokurimit me vlere te vogel

Ne mbeshtetje te nenit 29, pika 5 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar si dhe Nenit 40, pika 2, Kreu IV te V.K.M-se nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", *me urdherin nr.05 Prot.date 07.01.2015 (i ndryshuar) me urdherin nr.80 Prot. date 25.05.2015, eshte krijuar Komisioni per Blerjet me Vlere te Vogel per vitin 2015. Po keshtu me urdherin nr.1 Prot. date 06.01.2016 eshte krijuar Komisioni per Blerjet me Vlere te Vogel per vitin 2016.* Komisioni ka administruar ne menyre te vazhdueshme te gjitha procedurat e prokurimit te realizuara nga Autoriteti Kontraktor per Blerjet me Vlere te Vogel.
Referuar RPPP, per AK rezulton te jene parashikuar per tu zhvillua gjate vitit 2015, 20 procedura prokurimi me Vlere te Vogel, me fond limit te pergjithshem 6 370 mije leke me tvsh. Sipas RRPP per vitin 2015, me ndryshimet e bera gjate vitit, ne sistemin elektronik jane zhvilluar 19 procedura prokurimi me Vlere te Vogel, dhe me vlere kontrate te lidhur 5 674.9 mije leke me tvsh.
Referuar RPPP, per AK jane planifikuar dhe miratuar per tu zhvillua gjate vitit 2016, 19 procedura prokurimi me Vlere te Vogel, me fond limit te pergjithshem 5 630 mije leke me tvsh. Sipas RRPP per vitin 2016, me ndryshimet e bera gjate vitit, jane realizuar ne sistemin elektronik 18 procedura prokurimi me vlere te vogel, me vlere kontrate te lidhur 5 140.20 mije leke me tvsh.
Nga auditimi rezultoi se mbahet **regjistri analitik** per realizimin e prokurimeve me Vlere te Vogel per cdo urdher shpenzim/procedure prokurimi te realizuar me qellim respektimin e kufirit maksimal te lejuar deri 800 000 leke pa tvsh dhe per blerjet me formularin 5 "Per blerjet me vlere nen 100 000 leke pa tvsh per nje artikull ose grup artikujsh me te njejtin funksio (brenda vitit kalendarik).
Per vitin 2015, me zgjedhje u audituan 8 procedura prokurimi me vlere te vogel te realizuar ne sistemin elektronik dhe 5 procedura prokurimi te zhvilluar ne menyre shkresore.
Per vitin 2016, me zgjedhje u audituan 9 procedura prokurimi me vlere te vogel te realizuar ne sistemin elektronik dhe 7 procedura prokurimi te zhvilluar ne menyre shkresore.
Nga verifikimi ne sistemin elektronik dhe dokumentacionit perkates, rezultoi se ne pergjithesi eshte vepruar ne përputhje me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar. VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar. Udhezimin Nr.05 , datë 27.01.2015 "Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik". Udhezimin Nr. 1, datë 21.04.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël". Te gjitha procedurat e prokurimet me vlere te vogel te zhvilluara ne sistemin elektronik dhe ne menyre shkresore, rezultojne me dokumentacion shoqerues standart te parashikuar ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi, me perjashtim te disa te metave dhe mangesive te konstatuara dhe te trajtuara me poshte per periudhen nen auditim, konkretisht:

1. Jane realizuar 12 blerje me Formularin 5, brenda vitit kalendarik, ne raste kur per nje artikull apo grup artikujsh me te njejten funksion apo perberje eshte **realizuar nje here procedura e prokurimit me Vlere te Vogel** ne sistemin e lektronik (behet fjale per artikujt e blere mbi 100 000 leke brenda vitit) : konkretisht Up nr.54 Prot, date 15.09.2015, me fond limit 30 000 leke, "Mbushje tonera". Ush nr.450, dt. 15.12.2015, likujduar Artion Bajramaj, ne vleren 22 750 leke, per blerje kancelari. Ush nr.312, dt.02.10.2015, paguar Ariana Shkodra, ne shumen 26.600 leke, per mbushje tonera. Per keto raste dhe per disa raste te tjera eshte realizuar procedura e prokurimit

nje here ne sistemin elektronik gjate vitit kalendarik. Po brenda vitit per keto artikuj apo sherbime eshte realizuar edhe procedura e prokurimit me Vlere te Vogel nen 100 000 leke pa tvsh ne menyre shkresore me Formularin 5.

2. Mos argumentimi/dokumentim si duhet i **fondit limit** per procedurat e zhvilluara, ne 5 raste nuk eshte hartuar Procesverbali per argumentimin e fondit limit; Ush nr.593, date 22.12.2016, paguar Teuta Print, PF ne vleren 70 000 leke, per blerje kancelari; Ush nr.536, date 28.11.2016, likujduar Artion Bajramaj, PF, ne vleren 22 750 leke; Ush nr.534, date 28.11.2016, likujduar Mrika Luku, PF, per furnizim me materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme ne vleren 15300 leke; Ush nr.530 date 24/11/2016, likujduar Shkelqim Qendro, PF ne vleren 45 000 leke, per blerjen e 10 cope Tonera; USH nr. 527, dat 24/11/2016, paguar Ilir Beci, ne vleren 48 600 leke; Veprim i cili bie ndesh me Udhezimin Nr. 3, datë 27.01.2015 "Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, datë 24.04.2017, paragrafi trete pika 4, ku citohet... *"Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme".*

4.6. Sistemi IT

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres aktualisht ka 40 përdorues të brendshëm kompjuteri.
Nga testimi qe beri grupi auditimit ne lidhje me funksionimin e programeve te IT qe perdor gjykata nuk rezultuan probleme.
- Në zbatim të kerkesave të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, te ndryshuar mbi "Mbrojtjen e të dhënave personale", Udhëzimit Nr.15, datë 23.12.2011 për "Përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqesor", Vendimit Nr. 1, datë 04.03.2010 për "Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale", si dhe akteve të tjera të Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Eshte hartuar dhe miratuar me urdherin Nr. 143, date 31.07.2015 ***"Rregullore për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës"*** ne te cilen perfshihen rregulla te perdorimit dhe ruajtjes se mjeteve te TI, perdorimin e postes elektronike, siguria dhe mbrojtja e te dhenave.
Sistemi IT ne gjykate eshte funksional.

V. Zbatimi i rekomandimeve te lena nga auditimi i meparshem

Gjykata eshte audituar per here te fundit ne vitin 2015, nga Kontrolli i Larte i Shtetit.
Ne shkresen nr.986/8 date 31.03.2015 "Raporti perfundimtar i auditimit dhe Rekomandimet", jane lene 14 rekomandime, nga keto:
Masa Organizative; 12 rekomandime.
Masa shperblim demi; 2 rekomandime.
Gjykata e rrethit Gjyqesor Durres ka reaguar ne lidhje me rekomandimet e lena me shkresen nr.1132 date 23.04.2015 "Masat e marra ne zbatim te rekomandimeve te raportit perfundimtar te auditimit" si dhe me shkresen me nr.2570 prot, date 05.10.2015, mbi raportimin periodik mbi masat e marra nga gjykata ne zbatim te rekomandimeve te raportit perfundimtar te auditimit. Nga ana e gjykates:

1-Jane konfirmuar 11 rekomandime dhe kundershtuar 1.
2-Jane konfirmuar 2 rekomandime per shperblim demi.
Nga auditimi rezultoi se: nga 14 rekomandime te lena, jane zbatuar 10, kundershtuar 1(nje) dhe ne proces zbatimi 3(tre).

VI. OBSERVACIONE

Observacioni i paraqitur nga gjykata me shkresën nr. 2779 prot. date 03.08.2017, protokolluar me nr.490 date 07.08.2017 ne ZABGJ u vlerësuan me përgjegjësi me gjithë tematikën dhe problematikën e trajtuar dhe në përfundim pretendimet e vleresuara te drejta dhe te mbeshtetura me dokumentacion jane reflektuar ne rapot, ndërsa pretendimet e gjetura si të pa drejta për shkak të mosdakortësisë nga gjykata trajtohen në aneksin shtesë që i bashkëlidhet raportit përfundimtar së bashku me arsyetimet përkatëse.

VII. KONKLUZIONE, REKOMANDIME DHE PLAN VEPRIMI I GJYKATES

Duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit të gjykates tuaj dhe në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra, bazuar në nenin 6, pika c të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" për arritjen e objektivave në vitin 2017 e në vazhdim kërkojmë dhënien e rekomandimeve **të dakortësuara** për ndreqjen e parregullsive, si dhe masat konkrete të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen sipas sistemeve si vijon:

I. Sistemi organizativ.

1. Nisur nga ndryshimi i legjislacionit per organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqesor, ne perputhje me nenin 37 germa "dhe" te Ligjit Nr.98, date 06.10.2016 "Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise". ***Te rishikohet dhe permiresohet Rregullorja e Brendshme,*** duke perfshire edhe detyrimet qe rrjedhin nga ligji nr.10296 date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ndryshuar me ligjin nr.110/2015.
Per sa kohe qe kjo rregullore eshte ne fuqi per ato pjese te saj qe nuk bien ndesh me ligjin dhe qe jane te zbatueshme, deri ne hartimin e rregulloreve nga KLGJ (me miratimin e pershkrimeve standarte te punes te nepunesve te administrates gjyqesore).

Niveli i prioritetit : i mesem

Afati i zbatimit : Deri me 30.09.2017 **Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin**

2. Te kerkohet ***shtese ne organike*** per 1(nje) sekretare regjistrus, 1 (nje) punonjes sigurie dhe 1(nje) ekonomist/llogaritar. Kjo do te ndikoje ne rritjen e cilesise te sherbimit ne sportelet ku ofrohen sherbime gjyqesore per publikun. Ne rritjen e sigurise ne gjykate, si dhe ne ndjekjen me mire te marredhenjeve/pagesave me te tretet si me Posten, OSHEE, UKT , kontrollin dhe pagesen e avokateve kryesisht etj. Te gjitha keto do te ndikojne ne perfomancen e gjykates.

Niveli i prioritetit : i mesem

Afati i zbatimit : Ne vijimesi **Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin**

2. Sistemi i hartimit dhe zbatimit te Buxhetit.

3. Sistemi i pagesave (Pagat, Transaksionet per blerjet, shpenzimet)

1. Te arketohet shuma ne vleren **103 663 leke** (***per llogaritjen me pak te sigurimit suplementare***), perkatesisht sipas evidentimit ne Tabelen Nr.2, te xhirohet per llogari te Sigurimeve Shoqerore, ne perputhje me Ligjin nr.8097, date 21.03.1996, i ndryshuar si dhe VKM-se Nr.77, date 28.01.2015 "Per Kontributet e Detyrueshme dhe Perfitimet nga Sistemi i Sigurimeve Shoqerore dhe Sigurimi i Kujdesit Shendetesor", i ndryshuar.

2. Për shpenzimet për avokatë, përkthyes, psikologë nga ana e gjykatës të përcaktohen procedura të qarta dhe punonjës përgjegjës të cilët të konfirmojne kryerjen e shërbimit duke respektuar sistemin e nënshkrimit të dyfishtë dhe jo paraqitjen drejtperdrejtë në degën e buxhetit e cila duhet të kryej vetëm kontrollin e ligjshmërise dhe rregullshmërisë para kryerjes së pagesave në përputhje me Ligjin 10296 datë 08/07/2010 "Për MFK" (i ndryshuar) neni 12 pika 3 nënpika "a" dhe "e".

Niveli i prioritetit: i larte

Afati i zbatimit : Deri ne 30/09/2017 **Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin**

4.Sitemi i raportimit publik

1. Furnizimi i automjeteve me karburant per muajin pasardhes te kryhet pas dorezimit te Flete-Udhetimit të plotesuar sipas standartit nga shoferi në zyren e buxhetit dhe kontrollit te saj.

Niveli i prioritetit: i larte

Afati i zbatimit : Deri ne 30/09/2017 **Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin**

5. Sistemi i prokurimeve me Vlere te Larte dhe Vlere te vogel

1. Ne perputhje me piken 1 dhe 2 te nenit 57 te VKM nr.914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ngrihet **Njësia e Prokurimit** per te administruar në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimeve "Me vlere te larte".

2. Kryetari i AK ne perputhje me nenin 68 te VKM-se 914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) per te pasur mundesine e ndarjes te punes te punonjesve qe do te perfshihen ne procedurat e prokurimit qe do te zhvilloje gjykata. Bazuar ne nenin 83 te VKM-se Nr.914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ti kerkohet ne menyre te vazhdueshme APP-se per ***trajnimin*** e punonjesve ose ne bashkepunim me Institucionet e tjera te specializuara ne kete drejtim.

3. Të merren masa për ***mbikqyrjen e cilësise*** të realizimit të kontratave te sherbimeve veçanërisht të ruajtjes dhe sigurisë fizikese te godinës se gjykatës në përputhje me nenin 77 te VKM-se nr.914 date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

4. Te inventarizohen, **protokollohen dhe arkivohen** dosjet e procedurave te prokurimit te realizuara gjate vitit 2015 dhe 2016. *Në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".*

Niveli i prioritetit : i mesem

Afati i zbatimit : Ne vijimesi **Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin**

Keto rekomandime pasi te vlersohen nga ju, do te sherbejne si baze per zbatimin e plan veprimit dhe reagimit, me qellim permiresimin e punes, duke nxjerre aktet perkates dhe personat pergjegjes qe do t'i zbatojne, ato gjate vitit 2017 e ne vazhdim.

Raporti perfundimtar hartohet ne dy kopje

Grupi i Auditimit

Inspektor Audit

Agim Koçi

Inspektor Audit

Aristotel Telhaj

Inspektor Audit

Marjana Sulshabanaj